

VENDIM
Nr. 713, datë 26.11.2025

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 893, DATË 17.12.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ORGANIZIMIT DHE TË
FUNKSIONIMIT TË KABINETEVE NDIHMËSE, TË ORGANIZIMIT TË
BRENDSHËM TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHETËRORE, SI DHE
PËR PROCEDURAT E HOLLËSISHME PËR PËRGATITJEN, PROPOZIMIN,
KONSULTIMIN DHE MIRATIMIN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17, pika 2, 21, pika 5, dhe 29, pika 1, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7, të vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabinetëve ndihmës, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, të ndryshuar, shtohen pikat 7/1, 7/2, 7/3, 7/4 dhe 7/5, me këtë përmbajtje:

“7/1. Pranë çdo ministri krijohet një këshill ekspertësh, me qëllim:

a) vlerësimin dhe dhënien e mendimeve për çështje të fushave të përgjegjësisë së ministrisë përkatëse;

b) propozimin dhe zhvillimin e iniciativave ligjore e nënligjore në fushën që i përket ministrisë përkatëse, me qëllim adresimin e çështjeve të caktuara që i përgjigjen realizimit të politikës së përgjithshme shtetërore;

c) kontribumin me njohuri dhe ekspertizë të posaçme profesionale për çështje të përgjithshme të proceseve, pjesë e fushës së përgjegjësisë;

ç) paraqitjen e rekomandimeve dhe zgjidhjeve të mundshme për adresimin e çështjeve e të problematikave të ndryshme, që lidhen me fushën e përgjegjësisë së ministrisë përkatëse.

7/2. Këshilli i ekspertëve përbëhet nga, maksimumi, 5 (pesë) anëtarë, por në asnjë rast më pak se 3 (tre), të emëruar nga ministri përkatës, ndërmjet personaliteteve të fushës përkatëse, me përvojë profesionale të paktën 9 (nëntë) vjet në fushën/fushat e ngjashme apo të lidhura me fushat e përgjegjësisë së ministrisë përkatëse.

7/3. Anëtarët e këshillit të ekspertëve e ushtrojnë këtë funksion për një periudhë 2-vjeçare, me të drejtë riemërimi.

7/4. Anëtarët e këshillit të ekspertëve përfitojnë shpërblimin në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

7/5. Këshilli i ekspertëve mbledhet sa herë e kërkon ministri dhe anëtarët e tij kryejnë detyra të ngarkuara nga ministri, brenda përcaktimeve të pikës 7/1, të këtij vendimi.”.

2. Përfundimisht për vitin 2025, ngritja e këshillave të ekspertëve bëhet brenda mundësive buxhetore për këtë vit.

3. Efektet financiare për vitin 2025 përballohen nga fondet buxhetore të miratuara me ligjin e buxhetit për këtë vit.

4. Ngarkohen ministrat për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama